



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.498/1 prot.

Peshkopi, më 17.06.2025

Lënda: Për vendimin nr.08, datë 12.06.2025 të Këshillit të Qarkut Dibër.

KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Qarkut Dibër nr.08, datë 12.06.2025 **“Për miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative dhe nivelit të pagave të administratës të këshillit Qarkut Dibër të miratuar në vendimin nr.01, datë 14.02.2025”**, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi, në zbatim të kuadrit ligjor përkatës, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Këshillit të Qarkut Dibër, që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHEHÇ





PREFEKTURA DIBER

Ardhur
Nr. 498 dt. 16.06.25REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT DIBËRNr. 176/1 prot.Peshkopi, më 12.06.2025

VENDIM

Nr. 08, dt. 12.06.2025

PËR

“MIRATIMIN E NJE NDRYSHIMI NE STRUKTUREN ORGANIZATIVE DHE NIVELIT TE PAGAVE TE ADMINISTRATES TE KESHILLIT QARKUT DIBER TE MIRATUAR NE VENDIMIN NR 01 DATE 14.02.2025 “

Në mbështetje të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 77 pika “ç” neni 83, Ligji nr 115/2024 “ Pwr buxhetin e vitit 2025”, Ligji nr 7961, datë 12.07.1995 “ Kodi i Punës si Republikës së Shqipërisë” me ndryshime Ligji nr 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr 893, datë 17.12.2014 “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, VKM nr 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, **Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 503, datë 01.08.2024** “Për disa ndryshime ne VKM nr 328, dt 31.05.2023” Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”. **Vendimin Këshillit të Ministrave Nr. 421, datë 26.06.2024** ” Për disa ndryshime ne VKM nr 325, dt 31.05.2023 ” Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike si dhe Ligji Nr 115/2024 “ Per Buxhetin e vitit 2024 “Neni 15 “ Pika 4 “ Numri I personeli administrative te keshillit Qarkut nuk mund te jete me shume se 13 . Ligji Nr 9244 date 17.06.2004 “ Per Mbrojtjen e tokes Bujqesore “ Indryshuar **Vendimi I Keshillit Qarkut Diber Nr 1 date 14.02.2025** “ Per miratimin e nje shtese ne Vendimin Nr 28 date 27.12.2024 per shtimin ne strukturen e Keshillit Qarkut te Inspektoriatit te Mbrojtjes Tokes ne Qark .VKM –ja Nr 80 date 28.01.2005 “ Per perberjen ,menyrat e funksionimit,detyrat dhe pergjegjesite e strukturave shteterore te mbrojtjes tokes bujqesore kreu IV Pika 1 “IMT –ja organizohet si Sektor I veçante prane Seksionit te Administrimit dhe Mbrojtjes Tokes ne Qark (sot DAMT) VKM –ja Nr 121 date 17.02.2011 ‘ Per menyrat e ushtrimit te funksioneve nga Drejtorite e Administrimit

dhe Mbrojtjes Tokes ne Qarqe dhe ZMMT ne Komuna dhe Bashki kreu I pika 1 "DAMT -ja funksionon si structure administrative e Keshillit Qarkut e perbere nga Drejtori dhe dy sektore : Sektori I Administrimit Tokes dhe b Sektori (Inspektoriati I Mbrojtjes Tokes (IMT).Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 12.062025, pasi mori në shqyrtim projektin e Kryesisë "Për miratimin si Sektor me vehte te Inspektoriatit te Mbrojtjes Tokes I perbere nga Pergjegjesi Sektorit (Kryeinspektori dhe dy Inspektore per Mbrojtjen e Tokes, me 8 (nëntë) vota pro,

VENDOSI:

1. Miratimin si sektor ne vehte te Inspektoriatit te Mbrojtjes Tokes I perbere nga Pergjegjesi (Kryeinspektori) dhe dy inspektore.
2. Te miratoje nivelin e pagave shtese per Sektorin e Inspektoriatit te Mbrojtjes Tokes sipas Lidhjes Nr 2 bashkangjitur.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Sektori I Çështjeve Ligjore
4. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.
6. U shpall me date 12/06/2025

Zv. KRYETARI

Armand Gjini

